

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikagard®-63 N

VESHJE MBROJTËSE EPOKSIDE ME 2 PËRBËRËS



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikagard®-63 N është veshje mbrojtëse me bazë rrëshire epokside me 2 përbërës, e ngjyrosur dhe me përbërje të plotë substancash solide.

PËRDORIMET

Sikagard®-63 N duhet të përdoret vetëm nga profesionistë me përvojë.

- Shtresë mbrojtëse me rezistencë ndaj kimikateve mbi beton, gur, llaçe dhe suva çimentoje, çimento epokside, produkte me bazë rrëshire epokside dhe çelik
- Shtresë mbrojtëse për depozita magazinimi dhe silose
- Veshje kundër korrodimit mbi çelik në impiantet e përpunimit të ushqimeve, veprat e ujërave të zeza, ferma, ndërmarrje agrikulturore, mjedise kimike dhe farmaceutike dhe industrinë e pijeve

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Pa tretës
- Rezistencë e mirë mekanike dhe kimike
- Trashësi e madhe shtrese
- I papërshkueshëm nga lëngjet
- Përzierje dhe aplikim i lehtë

INFORMACIONE MBI MJEDISIN

Pajtueshmëri me LEED v2009 IEQc 4.2: Materiale me çlirime të ulëta - Bojëra & veshje

MIRATIME / STANDARDE

Veshje për mbrojtjen e betonit sipas kërkesave të EN 1504-2/2004, DoP 0206060100300000011008, certifikuar nga Organi i Njoftuar FPC dhe mbart markën CE.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Rrëshirë epokside	
Ambalazhi	Përbërësi A	kovë 8.70 kg
	Përbërësi B	kovë 1.3 kg
Paraqitja / Ngjyra	RAL 7032 (pebble grey), ngjyra të tjera me porosi	
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit	
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar, në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +30°C. Të mbrohet nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor.	
Dendësia	Rrëshira e përzierë ~ 1.35 kg/l	(EN ISO 2811-1)
	Vlerat e dendësisë të përcaktuara në +23 °C	
Përmbajtja e substancave të ngurta	~100 %	

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje	> 1.5 N/mm ² në beton >15 N/mm ² në çelik >10 N/mm ² në alumin	(ISO 4624) (EN 24624) (EN 24624)
Rezistenca kimike	Për informacione të mëtejshme, ju lutemi kontaktoni me shërbimin teknik Sika.	
Rezistenca termike	Ekspozimi I përhershëm max. 3 ditë	Nxehtësi e thatë +40 °C +60 °C
Rezistenca ndaj difuzionit të avujve të ujit	μH ₂ O ~ 100 000	(EN ISO 7783-1)

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzjerjes	Përbërësi A : Përbërësi B = 83 : 17 për peshë			
Konsumimi	~0.15 kg/m ² për shtresë			
Trashësia e shtresës	~0.1 mm për shtresë			
Temperatura e mjedisit	+10 °C min. / +30 °C max.			
Lagështia relative e ajrit	< 80 %			
Temperatura e nënshtresës	+10 °C min. / +40 °C max. Min. 3 °C mbi pikën e vesës, kujdes kondensimin			
Koha e punueshmërisë	Temperatura	Koha		
	+10 °C	~30 min		
	+20 °C	~20 min		
	+30 °C	~10 min		
Koha e pritjes / mbiveshja	Temperatura	Min.	Max.	Tharja e plotë
	+10 °C	~9 orë	~3 ditë	~14 ditë
	+20 °C	~5 orë	~2 ditë	~9 ditë
	+30 °C	~4 orë	~1 ditë	~5 ditë

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS

Nënshtresa duhet të jetë e qëndrueshme, e pastër, e thatë, pa kontaminues si pislëqet, vaji, graso, veshje të vjetra, disarmantë, kore çimentoje dhe substanca të tjera që pengojnë ose ndikojnë tek ndërkapja. Mbi nënshtresat shumë absorbuese, të paqëndrueshme, të kontaminuara dhe jo me bazë çimentoje, duhet të merren masa parandaluese dhe të përdoret një prajmer i përshtatshëm.

PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Nënshtresë betoni

Nënshtresa e betonit duhet të përgatitet mekanikisht për të arritur një sipërfaqe me teksturë të hapur. Zonat e dobëta mbi nënshtresë duhet të hiqen dhe defektet e sipërfaqes si vrimat dhe zgavrat duhet të ekspozohen plotësisht. I gjithë pluhuri dhe materialet e lira dhe të shkrifëta duhet të hiqen plotësisht nga të gjitha sipërfaqet përpara aplikimit të produktit, preferohet me furçë dhe/ose fshesë thithëse elektrike.

Vrimat dhe zgavrat e hapura duhet të mbyllen me llaçin e përshtatshëm Sika® për mbushjen e poreve. Ashpërsia e nënshtresës duhet të nivelohet me një llaç të përshtatshëm nivelues dhe suvatues Sika®.

Nënshtresë çeliku

Sipërfaqja e çelikut duhet të përgatitet mekanikisht me pastrim me fryrje abrazive. Duhet të arrihet niveli SSPC-SP 10 "metal pothuajse i bardhë i pastruar me fryrje" ose niveli Sa 2 ½ sipas ISO EN 12944-4. Saldimet dhe fugat duhet të përgatiten sipas EN 14879, pjesa 1. Pas pastrimit me fryrje hiqni të gjithë pluhurin dhe materialin që u mblodh. Në mënyrë që të ruhen kushtet e sipërfaqes pas pastrimit me fryrje rekomandohet ajër i kondicionuar.

PËRZIERJA

Përpara përzjerjes së plotë, përzieni mekanikisht përbërësin A. Kur i gjithë përbërësi B është shtuar tek përbërësi A, përzieni vazhdimisht për 3 minuta derisa të përftohet një miks homogjen. Përdorni një mikser elektrik në shpejtësi të ulët (300–400 rpm) për të shmangur bllokimin e ajrit. Për të siguruar përzjerjen e duhur, hidheni materiali në një enë të pastër dhe

përzieni sërish.

APLIKIMI

Aplikoni me furçë, rul ose spërkatje pa ajër.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat me Thinner C menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar dhe/ose tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

KUFIZIME

- Mos aplikoni Sikagard®-63 N mbi nënshtresa me lagështi.
- Rezistenca ndaj varjes mbi sipërfaqet vertikale është < 100 µm.
- Sikagard®-63 N nuk mund të përdoret për shtresa të përforcuara me rrjetë fibrash qelqi.
- Sikagard®-63 N i freskët duhet të mbrohet nga shiu, kondensimi dhe uji për të paktën 24 orë.
- Për përputhje ekzakte ngjyrash, sigurohuni se materiali që do të përdoret është nga i njëjti numër serie prodhimi.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sikagard®-63 N

Mars 2019, Botimi 02.01

020606010030000001

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

UDHËZIMI 2004/41/CE - KUFIZIMI I EMETIMEVE TË LIDHJEVE ORGANIKE FLURORE

Sipas Udhëzimit të BE 2004/42, përmbajtja maksimale e lejuar e VOC (Kategori produkti IIA / j lloji sb) është 500 g/l (Kufizimet 2010) për produktin gati për përdorim. Përmbajtja maksimale e Sikagard®-63 N është <500 g/l VOC për produktin gati për përdorim.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sikagard-63N-sq-AL-(03-2019)-2-1.pdf



BUILDING TRUST